VASIL DILO

BIBLIOTEKA E SHTETIT
GJIROKASTËR
814-1
D 50

Trenat e mëngjeseve

poezi

Shqi
050

VASIL DILO

Trena të mëngjeseve

poezi

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

VASIL DILO

Redaktor
STAVRI DAJO

Trena të mëngjesit

Rrëshqisni mbi shinat me vesë,
nën qiellin blu me dy-tri yje,
ju presin punëtorët në stacione
me padurimin e një fëmije.

Ata ngrihen heret nga krevati,
ëndrrat e mëngjesit lënë në mes
dhe nisen drejt realitetit
që ëndërrimi kurrë të mos vdes.

Ngjiten shpejt në vagona
me bukën vënë nën sqetull,
djersa u lëviz poshtë këmishës
e dielli u pikon nëpër vetull.

U kujtohen fëmijët që flenë
dhe shohin ëndrra të njoma,
dora e tyre e dashur
kokat i përkëdhel akoma.

O trena të mëngjesit,
mushkrizgjeruar me punëtorë,
vetë jetën mbani ngarkuar
dhe lëmshin e diellit mëngjesor.

Shokët

I lëmë karrot dhe lopatat
e zbresim poshtë në xhade,
atje mbërriti autoboti
që sjell ujë çdo ditë për ne.

Shokët pinë me radhë e ikin,
na lënë të fundit ne të dy.
Në dorën tënde, të thashë unë,
do doja ujin që ta pi.

Ti buzëqeshe dhe i vure
duart e tua pranë e pranë,
unë doja që ai ujë
të ish pafund, si oqean.

Kështu përditë na lënë shokët,
të fundit, mua edhe ti,
njëherë të pimë në duart e tua,
njëherë të pimë në duart e mi.

Në vigjilje të prillit

Ca thonë se prilli buron nga malet,
ca thonë se prilli shpërthen nga fushat,
të tjerë thonë se pikon nga cicërimat,
të tjerë nga sythat e gjelbër
nëpër dru.

Vetëm unë e di se prilli
nis të pikojë nga sytë e tu.

Rruga që endet mbi çati

Ju, që e keni parë këtë rrugë,
thoni, ku ka tjetër të tillë, ku ka?!
Ti je e vetme në botë,
moj rrugë belholla nën kala.

Qyteti të jep nga fryma e tij,
nga heshtja e tisaj të jep kalaja,
ti shkon e brishtë mbi çatitë,
ti rend e lehtë nëpër maja.

Stinët pas teje u harruan
dhe nisën grindjen një ditë,
po ti rishtas i pajtove,
moj rrugë që endesh mbi çatitë.

Të fshehtat e tyre t'i tregojnë,
të rinjtë që vijnë shpesh aty,
askujt s'ia thua ti ato,
askush veç teje nuk i di.

Harqet e qytetit tim

Qyteti im!
Ti nuk ngrite kurrë harqe triumfi,
se pas luftës
një luftë tjetër do të vinte
dhe ti s'kishe nge të mirreshe me to,
ndaj
në kubetë e pafundme që ndërtove
i pate përfshirë edhe ato.

Kështu u burrërove ti,
qyteti im!
Mbi kube të forta
u ngrit çdo shtëpi.
Heroizmi u takonte të gjithëve,
ndaj ti s'ngrite harqe për një njeri.

Një pendë pulëbardhe

Të shkrova për perëndimin e diellit këtu në Zvërnec,
për varkën e heshtur...
Të shkrova për ishullin
që ngjan si një iriq vigan i kredhur në det...

Pastaj një pendë pulëbardhe të futa në letër,
në pamundësi që drejt teje
të fluturoja vetë.

Mos i flakni papuçet

Nëna,
mos i flakni papuçet e të vegjëlve!
Atje janë hapëzat e para të fëmijëve,
«marshimet» e para mbi dhe.

Nëna, mos i flakni papuçet!
Atje është «udhëtimi i parë rreth universit»
pavarësia e njeriut fillon atje.

Kur të na jenë zbardhur flokët
e pleqëria të ketë trokitur në derë,
ndofta ato papuçe të vogla
do donim t'i shihnim edhe një herë.

Me dritare nga deti

Kështu do të vij te ty, Sarandë,
me kujtimin e kaltër që brenda syrit më mbeti,
dhe hotelxhiut me gjyslykë do t'i them.
— Ej, xhaxha!
Një dhomë me dritare nga deti.

Se kur të iki prapë
do marr në çantë ca guacka, ca yje,
do marr një copëz të kaltër jete...
Po detin... detin e paanë
nuk mund ta marr dot me vete.

Përreth minierës

Ata u futën në ashensor
dhe nisën të ngjiten sipër;
ora e dorëzimit të turnit kish ardhë.
Përreth minierës hapej dëbora,
e pafund, si zemra e tyre e bardhë.

Minatorët mbetën një çast pa folur,
vështronin tej
dhe kapelet i shtrëngonin në dorë.
Të befasuar, ashtu siç ishin,
filluan të luanin me dëborë.

Poshtë në minierë nuk ka qiell me re,
nuk ka pëllumba
dhe dëborë nuk bie atje,
prandaj ata e duan qiellin
ndofta më tepër sesa ne.

E diel dimri

Qielli sipër plumb,
malet poshtë gri...
Ecim faqepuqur:
unë edhe ti.

Horizonti tutje
hapet madhështor;
varganet e reve
na e bëjnë me dorë.

Rruga me dëborë
(ende e pashkelur)
si një dashuri
që porsa ka çelur.

Shumë i zbehtë dielli,
lundron në një cep;
duart ne i mbajmë
bashkë në një xhep.

Ja dhe zogu i vogël
që shkon nëpër ledh,
mbi flokët e tua
një fjollë bore hedh.

Fjollën e dëborës
s'e prekim me duar,
dhe ti ngjan ashtu
si e nusëruar.

Qielli sipër plumb
majëmalet i fsheh,
thonë se dashuria
stinët nuk i njeh.

Ksamil

Po hyjmë në Ksamil.
Një heshtje e papritur bie,
një fjalë askush nuk e flet.

Ksamili na e mori gojën
dhe nisi të flasë vetë.

47-SPS

Kalove ti...

Në rrugë ti papritur kalove;
mua koka andej më mbeti sa të pikasa.
Të ndiqja me mall, kisha vite pa të parë...
Po befas
me një grua të moshuar u përplasa.

Ti ndofta qeshe me mua,
a ndofta ike pa më vënë re
dhe s'e dëgjove çfarë më tha ajo grua:
— S'ka gjë, tha ajo, s'ka gjë!
Kështu më ka ndodhur edhe mua...

2914

Ne Shekspir nuk kishim

Ç'llahtara erdhën
e ç'mynxyra ikën
më mirë se kjo tokë askush nuk i di,
vërtet Shekspir ne nuk kishim,
po kishim shekuj me tragjedi.

I mbarti populli mbi kurriz
ngjarjet e egra nëpër natë,
o ç'rridhnin nga trupi i tyre
përrenj gjaku të pamatë!

Dhe erdhën gjer në ditët tona,
siç vijnë gurët dorë më dorë,
para atyre tragjedive
Shekspiri duket fëmijnor.

Erdhën i thanë të gjitha ç'dinin,
erdhën i thanë një nga një,
që ato kohëra gjëmëzeza
mbi këtë tokë mos kthehen më.

Bashkudhëtari im

Te pragu i shtëpisë sonë
me kallamishte dhe me baltë,
qerre shumë kishin kaluar
edhe fshatarë mustaqeartë.

Te pragu i shtëpisë pushonin
e pinin ujë te pusi ynë,
duhan shkëmbenin me babanë
dhe dy tri fjalë për lirinë.

Vitet me uturimë kaluan
si vargani i trenave kalon,
mbi pragun që e hëngrën vitet
një shtresë ne hodhëm me beton.

Tani mbi pragun e shtëpisë
trenat rrëshqasin në dy dej,
po babai im nuk është më
me ta cigare të shkëmbej'.

Unë të dy duart lart i ngre
kur trenat turren që matanë,
për vete njërën dorë e ngre
dhe dorën tjetër për babanë.

Qytetar

qytetit tim.

I ndjek frymëmarrjen ditë e natë
dhe ndiej si zien gjoks i tij,
si zbrazen turnet me punëtorë,
si mbushen sheshet me fëmijë.

Dua vajzat e qytetit tim, pleqtë
që kalldrëmet e pjerrëta ngjisin,
i dua vjeshtat dhe dimrat e tij
i dua rrufetë që qiejt grisin.

Në këtë pikë të gurtë të globit
lajmet më zënë shpesh në këmbë,
ndodh që gjoksi të më ngrihet
e ndodh që zemra të më dhëmbë.

Jam banor i thjeshtë i qytetit tim,
po jetën s'e dua të thjeshtë,
në mes të lavës së tij qëndroj
si mes një vullkani që s'di të heshtë.

Nderim koçekëve

Ej, koçekë të thjeshtë,
luani brinjët e drunjta
dhe barkun gjysmë të zverdhur!
Retë që shpejtojnë atje sipër
nuk kanë më shira për të derdhur.

Ja, po zgjohet qyteti matanë
e pranë bukës së ngrohtë ulet në tryezë,
ky është ligji i parë i jetës
e kështu do mbetet nga brezi në brez.

Se jeta ka thashetheme, ka luftëra,
jeta ka pranverë, dimër e vjeshtë,
jeta ka dashuri dhe urrejtje
por, mbi të gjitha, ka ngrënien e thjeshtë.

Ndaj këto rreshta
i hedh tani për koçekët
se edhe andej nis për mua gjithësia,
e aq më bën për atë që thotë:
Pse, me koçekët do merret poezia?!

Një thikë buke në muzeun e Skraparit

U ndala
para kësaj thike të çetës partizane
që më shumë uri ka ndarë sesa bukë,
në kokë më trokasin mendimet
si pikat e shiut mbi ullukë.

Ajo e di mirë
se buka që ndau në luftë qe e paktë,
e di se ëndrra e lirisë i ushqeu ata më tepër se buka
dhe i bëri të vërviteshin mbi flakët.

E marr ngadalë,
e shtrëngoj në pëllëmbë
e ca fjalë vijnë e më mblidhen në grykë...
Këtë thikë të thjeshtë po e harruam
le të bjerë mallkimi:
Buka, na zëntë sytë!

Shkelmin kam vënë

Duart ke zgjatur drejt meje
të më marrësh,
litarë ke hedhur
të më mbytësh,
erërave u fryn
të më shuash zjarrin e dëshirave...
Po unë shkelmin kam vënë mbi ty,
moj botë e kotë
e vogëlsirave!

Nuk është kaq e thjeshtë të përleshesh me ty,
ti je e padukshme si një hije,
herë shfaqesh si vajzë e bukur,
herë shndërrohesh në lypsare;
me plumb nuk vritesh dot ti
as digjesh dot me zjarre.

E ndjek pas njériun pa iu ndarë,
i lëpihesh gjithë jetën
me këmbënguljen që vëlët i lëpihen gjiut,
Vetëm një gjëje i trëmbesh ti:
punës së përditshme të njeriut.

Dolli për tokën

Në atë dasmë fshatarësh
ishin ngritur gjithë dollitë më parë,
kur andej nga mesi i tavolinës
u çua më këmbë një fshatar.

Kemi harruar një gjë, tha ai
dhe nga dritaret e hapura ktheu kokën.
Ta pimë këtë dolli, shokë,
ta pimë këtë dolli
për tokën!

U ngritën më këmbë dasmorët,
qelqet e rakisë i trokitën me zjarr,
toka matanë u buzëqeshte,
toka matanë nga shiu e larë.

Plakat dhe renegatët

Pse s'e ha ujku, mallkoi njëra plakë
kur televizori në lajme
një renegat tregonte,
Ç'thua, moj, tha plaka, tjetër,
edhe ujkun ai do ta helmonte.

Në psikologjinë e plakave
ata lëvizin si gjarpërinj me helm shumë të rëndë,
kështu ua shpjegojnë edhe fëmijëve ato
që t'u ngulet mirë nëpër mend.

Plakat nuk mbajnë mend emra,
kanë harruar ç'moshë kanë,
nuk e dinë duart qëkur i kanë me brumë...
Po nuk harrojnë ato se gjarpri
të kafshon edhe në gjumë.

Dialog i një tragjedie që nuk do luhet më

— O pampor, o dhogë e zezë,
pse s'të bie zjarri!
— Do të vijë tjetri, moj nënë,
edhe do të më marri.

— Mos harro nënën e shkretë,
ah, kurbeteve!
— Dhe i vdekur do të kthehem
sipër amaneteve.

— O pampor, o dhogë e bardhë,
djalin të ma biesh!
— Në s'ma prufsh dhe këtë herë
këmbët të m'i thyesh.

.....

Ç'kanë lisat që rënkojnë
nga brinja në brinjë?
Ç'kanë këmishët që zverdhojnë
s'lahen as me finjë?

Ç'kanë nuset që e gdhijnë
me lot të patharë?
Ç'kanë qentë që angullijnë
dimër e behar?

Na mbenë djemtë, na mbenë
ah, kurbeteve!
Veç murlani në i sjelltë
vendlindjeve.

Frynë kohët e i hapën
flamujt kuqezi,
s'do të luhet kurrë më
ajo tragjedi.

Kryengritësit

Kryengritësit
nuk kishin flamuj mëndafshi,
nuk kishin shkresa të mbushura me vula
as bori të bukura prej tunxhi.
Ata lëshoheshin e bënin një hata
vetëm nën thirrjen e përflaktë:
«O burra,
përmbi ta!»

Ktheheshin përsëri:
pa flamuj,
pa shkresa,
pa bori...
Plagët i fshihnin nën guna
dhe era kundërmonte trimëri.

Kaçanik

Me sy
nuk e kam parë ndonjëherë Grykën e Kaçanikut,
po në imagjinatën time më shfaqet
si një nofull e madhe prej guri...
Bluan e bluan përjetësisht armiq,
nga të gjitha anët që koha ia pruri.

Bujku që ra dëshmor

Duke pritur urdhrin e sulmit,
ti kuvendoje hën zë me kaun e plakur,
i flisje për farën e paktë të misrit,
i flisje për plorin që ndryshkej në lëndinë...
Ti ishe dy herë bujk i fidershëm,
se kishe dalë malit të mbillje edhe lirinë.

Atë mëngjes që re
buzët i vure pas këtij dheu,
e t'u shfaq pranë kau që shpesh të lëpinte
flokët...
Liria të puthi ballin atë ditë
dhe shokët përreth
kapelet hoqën nga kokët.

Me kaun tënd
atë çast të ngjau
sikur ugare të gjera ishe duke çarë...
Njërën dorë me barut e kishe
ndërsa tjetrën e kishe me farë.

Varri i heroit

Ishte luftë,
dimër
dhe varrin në bregun e lumit me zaje ia bënë.
Lumi vërviti atje stërkala
dhe qielli përsipër derdhi hënë.

Nga dherat e huaj
u sulën prapë armiqtë,
të një fisi me të parët ata ishin.
Për varrin në bregun e lumit
paguan ca njerëz që ta prishin.

Ata shkuan një natë,
e goditën fort me kazmë,
po nuk mundën ta prishnin dot.

Lumi poshtë ridhte i egër,
ata sipër përpiqeshin më kot.

Të nesërmen lumi u ngrit
me ujëra të reja vërshoi.
Dhe afër asnjeri nuk lejoi t'i shkonte,
kur ujërat e tij u qetësuan
varri i heroit mbi një ishull të vogël qëndronte.

Kështu thanë fashistët

«Mendja e tij nuk duhet të funksionojë!» —
kështu thanë fashistët për Antonio Gramshin
dhe e futën në burgjet e errëta,
e izoluan për vite me radhë
dhe kyçet e dyerve i përdrodhën,
po mendjen s'ia kyçën dot ata,
po mendjen dot nuk ia vodhën.

Nga hekurat e dritareve
rrugëve të Romës fluturoi ajo
edhe tani me punëtorët
plane të reja betejash thur,
fashistët e ndjekin akoma,
po s'kanë për ta kapur dot kurrë.

Froni i Skënderbeut

Froni yt i madh humbi atëherë mes tallazesh,
po ti
i udhëhoqe shqiptarët pa u lodhur
për pesëqind e ca vjet,
sepse thellë në zemrën e tyre
qëndronte froni yt i vërtetë.

Nata e Themistokliut

Ku të shpinin
atë natë të lidhur?
Atë natë mes territ të zi
ku të shpinin, Themistokli?

Mes tyre
i vetëm shkoje,
i vetëm mes asaj nate lubi,
flokëtrazuar ishe, Themistokli!

Në duart e tua
tundeshin prangat,
tundeshin prangat po nuk zgjonin njeri.
Askush s'kishte fjetur, Themistokli!

Të pat thënë gruaja
që ata të kërkuan,
që ata do vinin të të merrnin ty.
Të kish thënë gruaja, Themistokli!

Po ti nuk ike,
nuk u fshehe kurrkund,
i prite si burrë i vërtetë i dheut.
Vdekja jote atë ditë i duhej atdheut.

Qielli përsipër,
veç vetëtimash,
tjetër ç'mund të hidhte për ty?!
E ç'mund të hidhte tjetër, Themistokli!

Gjurmëve të tua
mbinin lulet e shqipes,
nxirrte bisqe alfabeti i ri,
Gjurmëve të përgjakura, Themistokli!

Burgu i Selanikut
nuk ta nxinte dot zemrën,
nuk ta nxinte diellin në sy.
Prandaj ti buzëqeshje, Themistokli!

Qielli i atdheut,
veç vetëtimash,
tjetër ç'mund të hidhte për ty?!
E ç'mund të hidhte tjetër, Themistokli!

Te varri simbolik i Musa Fratarit

Përmet

O erëra që ikni drejt Pirenejve!
Ngrini një re,
ngrini një re vigane me gjethe blirë
dhe hidheni mbi atë baltë të kuqe
ku prehet Musai me shokë,
ku dhe vetëtimave që shkojnë
u dridhet kërciri.

Nuk mundëm t'i gjenim eshtrat e tij,
qenë bashkuar me të luftëtarëve
që në një ditë së bashku i vranë.
Jeta i bashkoi ata
dhe vdekja vetë dot nuk i ndan.

O erëra që suleni drejt Pirenejve!
Rrëmbeni një kaba
dhe hidheni atje ku ngrihen barrikada,
atje ku nis të fryjë përsëri uragan...

Pushkatimi

E vetmja dorë e saktë që kish
qe gjithnjë e përlyer nga gjaku,
krimet e tij
në kujtesën e qytetit ishin ngulur si hunjtë...
Erdhën orët e para të Çlirimit,
kërkonim ballistin
me një dorë të drunjtë.

E gjetëm,
e mbështetëm te muri,
por diçka kërceu tutje me vrull
kur tyta jonë mbi të nisi të pështyjë.
Ishte druri
që më në fund pó çlirohej nga qenia e tij..

Brinja e Mademeve

Ja brinja!
Në gjinjtë e saj nuk pikon lëngu i mollës
dhe hëna
nuk çlodhet dot këtu mbi bisqe e drurë,
këtu sundon afshi i shkëmbit të çarë
dhe tymi i dinamitit që bredh nëpër gurë.

Nuk ka këtu fëshfërima gjethesh,
as kokrra të fryra qershie,
as vajza që mbushin arkat me dardhë,
këtu ka vetëm punëtorë mademesh
dhe karroceri makinash me shkëmbinj të bardhë.

Dredhon vargu i makinave,
shtegtojnë statujat,

udhëtojnë lagjet e reja, muret e shtëpive,
rrinë bashkë mbi karroceri themelet e
kopshteve
me themelet e metalurgjive.

E tërë kjo pllajë
do ketë hipur një ditë mbi makinë
me njerëzit do ketë shkuar të jetojë.
E ardhmja në pllaja të tjera do sulet
e nën pluhurin e bardhë të gurit
do ëndërroj.

E qeshura jonë

I përplasim fort gotat e birrës:
unë dhe shoku im i ngushtë punëtor,
ashtu do t'i përplasnim edhe zemrat
po t'i nxirrnim dot mbi kraharor.

Nuk jemi ne pompozë në shoqëri
dhe njëri-tjetrit nuk i mbajmë fjalime.
Kur i përplasim gotat e birrës,
do të derdhet gjithnjë gota ime.

Dhe qeshim të dy me tërsëllëm,
qeshim me shtrëngatë sipër gotës;
ai është punëtor dhe unë letrar,
e qeshura jonë i duhet botës.

Një avion amerikan në kalanë e Gjirokastrës

Gjatë luftës
shumë avionë hëngri kjo tokë,
i pari u rrëzua me plumbat që i mbanim
torbave.
Po më i mjeri nga të gjithë avionët është
ky
që përditë fëlliqet
nga glasat e korbave.

Grykat e Kurveleshit

Hej,
gryka të Kurveleshit!
Të shpuara nga isua përjetë,
gryka të gërryera nga gjaku,
gryka të krisura nga rrufetë!

Këtu e pa armiku si luftohet,
këtu e pa vdekja si bëhet përshesh,
nëpër këto pesë gryka
vetëm pesë cepat e yllit kaluan,
thellë
në zemrën tënde, Kurvelesh.

U r i a

Mëngjeseve,
kur traktorët e mbuluar me vesë
zënë të shkrofëtijnë
e të kërcasin me furi,
më ngjan sikur nën zinxhirët e tyre
jep shpirt ajo,
më çnjerëzorja fjalë
uri.

Si një qen i zi
rrugëve të gjithë botës bredh ajo
me torbën e saj të madhe e të shpuar.
Për në vendin tonë, o njerëz,
mos t'ia japim kurrë
vizën për të kaluar.

Duan të thonë...

Ai nuk ngjante fare me servilët klasikë,
ishte i pashëm,
trupin e kishte të drejtë.
Po, po, të drejtë, tamam si një shtizë.

Megjithatë, kur vdiq,
duan të thonë se punëtorët e komunales
arkivolin e tij e bënë me kurriz.

Piazza Dei Fiore[1]

Këtu në Sheshin e Luleve
të dogjën inkuizitorët,
Xhordano...
Po as ata nuk e besuan
se ti u dogje me të vërtetë.
Megjithëse hirin e kontrolluan mirë,
dyshimi i hëngri për treqind e ca vjet.

Dhe vërtet, atje
ti u shfaqe pas treqind vjetësh
me syrin tërë të patrembur,
me syrin tënd të mbushur plot mall,
me duart që u ndridhen ata vijnë e të prekin
në je vërtet prej bronzi
apo je prej mishi të gjallë.

1. Sheshi ku është djegur mbi turrën e drurëve Xhordano Bruno

Mot i largët

baladë

Një natë një nuse panë armiqtë
te çezma e një fshati,
natë e errët, thonë se ish,
s'dihej sa qe sahati.

Tek një mejhane në xhade
i thanë: «Hajde përdridhu!
Na hiq këtë mërzi të rëndë
dhe nga jelekët zgjidhu!

Ajo nuk fliste asnjë fjalë
vështrimin poshtë mbërthyer,
dikush iu qas me një gotë
dhe me një sy të shqyer.

Ajo pa rreth e rreth njëherë
po dorën poshtë e uli.
Nga brez i saj nxori një thikë
dhe nëpër gjinj e nguli.

Gërneta heshti menjëherë,
ca qelqe u rrëzuan.
Ata u ngritën një nga një
dhe kuajt i lëshuan...

Pija e ngrirë mbi tryezë
s'kuptohej se çfarë ishte,
verë ish, a gjak i kuq?
A brenda farmak kishte?

Mot i largët ishte ai
me kuje dhe mandatë,
akoma kuajt i dëgjoj
si ikin nëpër natë.

Dëshmorit Pali Prifti

Si tri manushaqe të brishta
që kanë mbirë në një pllajë mali,
ashtu kanë çelur pranë pushkëve e gjerdanëve
tri vizatimet e tua të thjeshta,
Pali.

Mbi shpinën e çantës
a ndofta mbi kondakun e pushkës i ke bërë,
kur mendimet në Shqipërinë e lirë të
fluturonin;
vizatimet e tua këtu në muze
u tregojnë njerëzve
se dhe gjaku i piktorëve
e skuqi revolucionin.

Thodhori Mastora

Ti ishe nga një degë ustallarësh
me çekiç, me sharrë e mistri,
që shtëpi për vete s'ngritën dot,
Thodhori, Thodhori!

Me shokë të shumtë u rrite,
si ty qenë ata, pa shtëpi,
nën gjokse zemra s'iu qëndronte
Thodhori, Thodhori!

Një natë erdhi lajmi në fshat:
ti kishe rënë larg, në Mal të Zi,
pa ngritur dot shtëpi për vete,
Thodhori, Thodhori!

Por një botë të tërë ngrite me shokë
pa çekan, pa sharrë e mistri.
Me gjakun tuaj e mbuluat,
Thodhori, Thodhori!

Përpara kongresit

Unë nuk do t'ju them për rrugët e veshura me flamuj,
për galeritë e hapura tejpërtej,
për vallet e hedhura mes sheshit...
Unë do t'ju them për Altinin e vogël
që i thoshte të vëllait një mëngjes:
— Liri, vishu mirë!
Vishu mirë tani
përpara kongresit.

Të gjithëve na ka qëlluar
të habitemi para fëmijëve, të ngazëllehemi
dhe kokën e bukur t'ua marrim në duar,
Te ato fjalë të thëna sinqerisht,
qysh tani
ditët e së ardhmes kanë bleruar.

Sonte

Eoim ndanë Lanës.
Dora ime diçka i thotë dorës sate,
nga degët e plepave
qielli mbi ne ka marrë formën e rombit.
Sonte ti thë:
— Sa qetësi ka ky bulevard!
Dhe unë të thashë:
— Më kot nuk quhet
«Dëshmorët e kombit»!

Dëshira e urës së vjetër

Pranë urës së vjetër prej guri
u ngrit ura e re
dhe vërshuan atje pleq, makina, fëmijë të
gëzuar
ndërsa mbi urën e vjetër
kalon tek-tuk ndonjë çift i vetmuar.

Ajo e kreu detyrën ndaj njerëzve.
Vetëm një dëshirë i ka mbetur tani:
Mbi urën e re
të kalojë edhe ajo njëherë mes për mes,
të rendë mbi të, të gëzojë...
Dhe pastaj,
pastaj le të vdesë.

Nata po thyhet

Është vonë. Nata po thyhet.
Unë faqet e librit kthej me ngadalë.
Nëna më thotë përsëri:
— Po fli!
Fli tani, more djalë!

Ajo dremit pas pak,
po përsëri lëviz,
se ndonjë ëndërr e keqe e mundon.
Diku, në një cep të ëndrrës
dhe mua patjetër më shikon.

Ngandonjëherë
unë ngrihem befas i trembur:
Frymëmarrja e saj përse nuk ndihet?
Lehtësohem vetëm kur shoh
se gjoksi i saj ulet e ngrihet.

Është vonë. Nëna fle.
Unë faqet e librit kthej me kujdes...
Jo,
nuk dua më ta mendoj
se nëna ime një ditë s'do të jetë.

Në shëtitoren «Stalingrad»

Ju, nëna,
që sonte shtyni karrocat e fëmijëve
në shëtitoren «Stalingrad»,
u mësoni atyre
se Stalingradi ka kohë që është tradhtuar,
ka kohë që gjaku i të rënëve
nga fusha e flamurit ka shtegtuar.

Ju, nëna, që sonte shtyni karrocat e fëmijëve
në shëtitoren «Stalingrad»,
u mësoni atyre se ajo vazo me dhe
që ka siellë andej Enver Hoxha,
nuk do të tradhtohet kurrë,
sado të jetë betejë e gjatë.

Jo, nuk do të tradhtohet,
dhe në u dashtë një ditë
që gjithë Shqipëria të bëhet Stalingrad.

Nënë, do të kthehem!

Shkruar në gavetën e një ushtari italian

Kur skalisje këtë gavetë të zbrazur si barku yt
me siguri të kish brejtur malli për nënën,
për rrugicën e shtruar me gjethe ulliri,
për gjurmët e motrës që mbeteshin mbi to.
Ndaj zbrazje shpirtin në gavetën e zbrazur:
«Mamma, ritornerò!»

Ëndrra jote e fundit,
brengat e tua
nuk dihet në ç'rrëpira mbetën ato,
po dihet se te kjo gavetë e zbrazur
mbetën fjalët e dhimbshme:
«Mamma, ritornerò!»

Këto rreshta janë për ju,
ushtarë të sotëm të pushtimeve,
që lakminë e të mëdhenjve shpini ngado,
të mos ketë më gaveta të zbrazura
me fjalët tragjike:

«Mamma, ritorneró!»

Zjarri i poetëve

Në cilën vatër sonte do rrini,
Hajne, Petëf, Pushkin, Bajron?...
T'ju mbush gotat sonte më lini
me musht që zien nga koha jonë.

Pluhur mbi rroba kini shumë
dhe buza duket fort e etur,
armiqtë ju ndjekin papushim,
po kurrë s'kanë për t'ju gjetur.

Ju kuajt ngisni natë e ditë
dhe merrni udhën për tek ne,
me gjak emrin e lirisë
ta thoni rishtaz përmbi dhe.

Gjëmim i shekujve të rinj
zërin tuaj s'e mbulon dot,
pas kalit vdekjen kini lidhur
dhe zvarrë e hiqni nëpër botë.

Në cilën vatër sonte do rrini,
Hajne, Petëf, Pushkin, Bajron?...
Në gota ç'zjarr poetësh hodhët
që nisi qielli e bubullon?

Gjurma e këngës, e gjakut tuaj
mbi dhe nuk mund të thahet dot,
pas kalit vdekjen keni lidhur
dhe osh e ndukni nëpër botë.

Rebelimi i busteve

Sovjeti Suprem, sovjeti i zi
veshur në rrobë të murgje,
kërkon të shpallë një ligj të ri:
«Të futen bustet nëpër burgje.»

Të futen bustet në hapsanë,
se japin shenja rebelimi,
ta qepin gojën menjëherë,
ndryshe i pret ripushkatimi.

Afrohen netve policët,
çfjalosen bustet nën zë?
T'u bien kokës me shkopinj,
t'u nxjerrin sytë një nga një.

Po ata zbresin fytyrëzbehtë,
(policët marrin arratinë)
trokasin bustet derë më derë
të çojnë më këmbë gjithë Rusinë.

Përse rënkojnë lokomotivat,
ku nisen trenat me ushtarë?
Hap duart, ndali Matrazov,
i bronztë hidhu mbi binarë!

Po hiqet zvarrë ai flamur
që ty t'u ndez nëpër duar,
nga lindja gjer në perëndim
lëngon Rusi e tradhtuar.

Po mund nga dheu i Leninit
e vërteta vallë të mërgohet?!
Ç'u nxi e ç'u shkrumbos aty
nga e para do të rikrijohet.

Moti i madh

Liria
është më e bukura lule e këtij dheu...
Po si një lule
askush, askush nuk ta fal lirinë.
Një hënë e përgjakur shfaqet tutje nga gjiri
e qëndron netve mbi Palestinë.

Miliona nga djersa e punëtorit
bëhen armë për të vrarë punëtorin,
një shkencë e tërë e njeriut për të vrarë njerinë,

Dhe hëna atje lart
si gur smerili u ngjan armiqve
ku mund të mprehin thikat supershtetet.

Po ne, proletarët,
zotërojmë shkencën më ekzakte, të kohëve
dhe me të, gjithë armiqve do t'u vijmë hakut;
Ne njohim shkencën e pagabueshme
të kimisë së gjakut.

Nuk e dimë sa do të zgjasë kjo luftë!
Nuk e dimë në ç'muaj,
nuk e dimë në ç'mot
armiqtë e fundit do t'i rrëzojnë poshtë honit,
po e dimë mirë se ai do të quhet
Moti i Madh i Revolucionit.

Në qenien tonë

Ku është varri i Engelsit
e dini ju, o proletarë?
Për djep token kish ai
dhe detet pati varr.

Po qenë të ngushta detet
për hirin e tij të rëndë,
ndaj e shpërndanë ata
në oqeane anë e kënd.

Dhe oqeanet e mëdha
ta mbanin dot nuk mund,
ndaj hiri i tij u shpërnda
në gjithësinë e pafund.

Dhe gjithësia e përcjell
hirin e tij përgjithmonë,
kështu ai do të ketë hyrë
brenda në qenien tonë.

Zinxhirët

Koha jonë
i la mbrapa arkitektët e bombardave,
përzierësit e famshëm të helmeve,
shpikësit e përrallave të vjetra biblike.
Sot
më të tmerrshëm se zinxhirët e tankeve
janë zinxhirët e çantave diplomatike.

Përherë ka pasur pëllumba...

Pëllumbat e bardhë,
të trembur rrahin krahët
duke marrë me vete vështrimin tonë...
Fluturojnë mbi çatitë,
fluturojnë mbi sahatët e kullave të ngelur qëkur.
Vëllezër,
bota përherë ka pasur pëllumba
por paqe nuk ka pasur kurrë.

Zjarr

Vërtet, ne punëtorëve na takon bota.
Po ne
ende, ende s'e kemi atë.
S'mjafton që kjo gjë e thjeshtë të dihet,
ajo
duhet vulosur me gjak përgjithnjë.

Zjarr Zambia!
Zjarr Irani!
Zjarr Guatemala!
Në të gjithë gjuhët e botës, shokë,
liria
është kryefjala.

E shkruar ditën e poezisë

Nuk e di ç'merita ka kjo ditë
që është quajtur «Dita e poezisë»,
nuk e di ç'korifej të vargut ka lindur,
ç'muza ka brenda,
ç'vërshime rimash të paprera.

Po unë e di mirë se kjo ditë
nuk ka shumë poezi
nga gjithë ditët tona të tjera.

PASQYRA E LËNDËS

Trena të mëngjesit 3
Shokët 5
Në vigjilje të prillit 7
Rruga që endet mbi çati 8
Harqet e qytetit tim 10
Një pendë pulëbardhe 11
Mos i flakni papuçet 12
Me dritare nga deti 13
Përreth minierës 14
E' diel dimri 15
Ksamil 17
Kalove ti... 18
Në Shekspir nuk kishim 19
Bashkudhëtari im 21
Qytetar 23
Nderim koçekëve 25

Një thikë buke në muzeun e Skraparit 27
Shkelmin kam vënë 28
Dolli për tokën 30
Plakat dhe renegatët 31
Dialog i një tragjedie që nuk do luhet më 32
Kryengritësit 34
Kaçanik 35
Bujku që ra dëshmor 36
Varri i heroit 38
Kështu thanë fashistët 40
Froni i Skënderbeut 41
Nata e Themistokliut 42
Te varri simbolik i Musa Fratarit 45
Pushkatimi 47
Brinja e mademeve 48
E qeshura jonë 50
Një avion amerikan në kalanë e Gjirokastrës 51
Grykat e Kurveleshit 52
Uria 53
Duan të thonë... 54
Piazza dei fiore 55
Mot i largët 56
Dëshmorit Pali Prifti 58
Theodhori Mastora 59
Përpara kongresit 61
Sonte 62
Dëshira e urës së vjetër 63
Nata po thyhet 64
Në shëtitoren «Stalingrad» 66
Nënën, do të kthehem! 68

Zjarri i poetëve 70
Rebelimi i busteve 72
Moti i madh 75
Zinxhirët 79
Përherë ka pasur pëllumba... 80
Zjarr 81
E shkruar ditën e poezisë 82

Dilo, V.

Trena të mëngjeseve. Poezi. [Red. S. Dajo] T., «Naim Frashëri», 1984.

88 f.

(B.m.) dhe

(B.v.): 891.983-1

D 50

Tirazhi 1500 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-79

KOMBINATI POLIGRAFIK, Shtypshkronja e Re — Tiranë, 1984.